



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 24.35.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË
AGJENCISË KUNDËR KORRUPSIONIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë Kundër Korrupsionit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit Ejup Simnica dhe Anëtare e ekipit Valbona Pllana, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Samir Zymeri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	13
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	16
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	17
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	20
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	22

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 26/03/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar.

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.


Për më gjerësisht shih Pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Drejtorin e Agjencisë dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimit të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Drejtorit – auditimi 2016

Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Kemi audituar PFV-të të Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren e MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Drejtori i AKK-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Drejtori i AKK-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

AKK kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Financiar Vjetor nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Në kontekst të PFV-ve, nuk kemi asnjë çështje për të ngritur. Po ashtu, në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për AKK-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga AKK siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja në AKK në lidhje me raportimin menaxherial dhe llogaridhënien pasqyron një situatë pozitive. Megjithatë edhe me tutje janë të nevojshme të behën përmirësime. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm ishte mjaft i ulët. Pyetësi i vet-vlerësimit, i plotësuar nga AKK, nuk e pasqyron plotësisht gjendjen aktuale. Komentet e dhëna mbi aranzhimet ekzistuese nuk bazohen mjaftueshëm në dëshmi. Më tej AKK, nuk ka përgatitur raportin e menaxhimit të rrezikut, i cili do të identifikojë rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të AKK-së për vitin 2016, ka rezultuar me pesë (5) rekomandime kryesore. AKK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, dy (2) rekomandime janë zbatuar, një (1) në proces të zbatimit, ndërsa dy (2) tjera nuk janë zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë zbatuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 1 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura	AKK ka hartuar me kohë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e vitit 2015, mirëpo nuk janë ndërmarr hapa konkret për të monitoruar dhe siguruar zbatimin e tyre.
	Rekomandimet të cilat nuk janë zbatuar ndërlidhen me pyetësin e vet-vlerësimit dhe listën e rreziqeve.
Rreziku	Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë me mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve dhe vështirësi në përmbushjen e objektivave.
Rekomandimi 1	Drejtori i AKK-së duhet të zbatojë një proces efektiv për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm, i cili përcakton kohën e synuar dhe zyrtarët përgjegjës për këtë. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve kohore, të rishikohen në një afat të shkurtër, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësit të vet-vlerësimit të AKK-së të dorëzuar në MF, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësit.

Ne kemi përmbledhur konkluzionet tona për AKK-në të cilat së bashku me të gjeturat dhe konkluzionet e nxjerra në auditimet tjera do të konsolidohen në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të jap koment për cilësinë e tërë pyetësit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do ta jap gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 - Plotësimi i pyetësorit të vet-vlerësimit dhe menaxhimi i rrezikut - Prioritet i lartë**E gjetura**

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë (5) komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi identifikuar se:

- Proceset efektive të monitorimit si dhe strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit konsiderohen si të vendosura nga AKK-ja, mirëpo dëshmitë në mbështetje të këtyre konkluzioneve nuk janë të plota. Strategjia kundër korrupsionit 2013-2017 nuk ka parashikuar kostot për zbatimin e të gjitha aktiviteteve;
- AKK-ja gjatë përgatitjes së pyetësorit të vet-vlerësimit ka dhënë përgjigje korrekte në shumicën e pyetjeve të parashtruara. Megjithatë, në një pjesë të tyre nuk ishin të bazuara në dëshmi apo veprime konkrete për të konfirmuar saktësinë e këtyre përgjigjeve; dhe
- Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosura. AKK-ja nuk ka arritur të hartojë matricën e rreziqeve siç e kërkon procedura e MFK-së duke mos identifikuar rreziqet që lidhen me objektivat e parapara me planin operativ dhe strategjik të organizatës.

Rreziku

Mosplotësimi si duhet i listës kontrolluese të vet-vlerësimit paraqet mungesë të informacionit për MF rreth funksionimit të sistemit të MFK-së. Mungesa e monitorimit të arritjes së objektivave rezulton me dobësi në procesin buxhetor si dhe zvogëlimin e mundësisë që menaxhmenti të reagojë me kohë ndaj sfidave. Ndërsa mos zbatimi i plotë i procesit të menaxhimit të rrezikut mund të ketë si pasojë ngecjen në realizimin e objektivave të përcaktuara në planin strategjik të AKK-së.

Rekomandimi 2

Drejtori i AKK-së duhet të sigurojë se janë përmbushur kërkesat e MF-së për të ofruar informacione të plota rreth funksionimit të sistemit të MFK-së. Pas plotësimit të pyetësorit duhet aplikuar mekanizëm të rishikimit për të konfirmuar saktësinë e të dhënave të prezantuara si dhe dëshmime për mbështetjen e tyre me të dhëna financiare. Rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet zhvillimit të procesit të menaxhimit të rrezikut në mënyrë që të parandalohen rreziqet të cilat pengojnë arritjen e objektivave të organizatës.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit AKK operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Menaxhmenti i AKK-së kishte dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.

Procesi i raportimit të brendshëm funksionon sipas vendimit të nxjerrë nga Drejtori i Agjencisë në përputhje me ligjin dhe strukturën organizative të AKK-së. Lidhur me këtë, menaxhmenti kishte mbajtur takime të rregullta me të gjitha departamentet dhe njësitë e saj, duke raportuar dhe diskutuar për të gjitha aktivitetet e saj.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Në bazë të kërkesave të udhëzimit administrativ nr. 23/2009, për themelimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, AKK nuk i plotëson kriteret për të themeluar këtë njësi. Megjithatë, me qëllim të forcimit të kontrollit të brendshëm, AKK kishte kërkuar nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm në kuadër të MF-së, për të kryer shërbimet e auditimit.

Në kohën kur ne ishim në auditim, Departamenti i Auditimit të Brendshëm në kuadër të MF-së ishte në proces të një auditimi.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, burimeve njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

AKK ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutores të sajë. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Në vitin 2016, AKK ka përdorur 97% të buxhet final. Trendi i shpenzimeve ndërmjet viteve është i ngjashëm dhe nxjerr në pah një nivel të vazhdueshëm dhe konsistent të ekzekutimit të buxhetit sipas planit të rrjedhjes së parasë.

Në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin, auditimi ynë nuk ka shpalosë ndonjë çështje domethënëse. Po ashtu lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore, pasurive dhe obligimeve nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi në menaxhimin dhe raportimin e tyre.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	501,666	446,321	431,925	526,488	555,073
Granti i Qeverisë -Buxheti	501,666	431,153	430,139	471,015	453,079
Donacionet e jashtme		15,167	1,785	55,473	101,994

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 55,345€ ose 11%. Ky zvogëlim është rezultat i rishikimit buxhetor.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Në vitin 2016, AKK ka përdorur 97% të buxhet final ose 431,925€, realizim i njëjtë (në përqindje) krahasuar me vitin 2015. Realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitë aktuale.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	501,666	446,321	431,925	526,488	555,073
Pagat dhe Mëditjet	354,258	354,709	354,709	346,767	340,202
Mallrat dhe Shërbimet	138,908	88,853	74,610	176,988	211,283
Shërbimet komunale	8,500	2,759	2,606	2,733	3,588

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Në kategorinë mallra dhe shërbime Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin nr.1/123 të datës 28.12.2016 ka tërhequr nga kjo kategori 65,222€. Ndërsa nga projekti i bankës botërore të mjetet e bartura për vitin 2016 janë 15,168€. Zvogëlimi i buxhetit për këtë kategori është 50,055€;
- Në komponentën e shërbimeve komunale janë zvogëluar për 5,741€, me vendimin Qeverisë; dhe
- Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, në fund të vitit MF rritë buxhetin në vlerën prej 450€, pa ndonjë vendim të shkruar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime për këtë fushë.

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrolllet kyçe në këtë proces kanë dëshmuar plotësinë dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara në PFV-të e AKK-së. Në këtë kategori ishin shpenzuar 354,709€ apo 100% të buxhetit final.

Për të nxjerrë një konkluzion për menaxhimin e pagave, ne rishikuam listat e pagave si dhe krahasuam të dhënat e prezantuara nga Thesari, SIMFK dhe prezantimin e tyre në PVF. Po ashtu ne kemi testuar edhe mirëmbajtjen e dosjeve të personelit.

Bazuar në këtë, ne kemi konstatuar se AKK ka vendosur sistem të mirë të kontrollit mbi fushën e kompensimeve (pagave dhe mëditjeve) dhe nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime për këtë fushë.

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë edhe komunalitetë) në vitin 2016 ishte 91,612€. Prej tyre ishin shpenzuar 77,216€, ose 84% e buxhetit.

Ne kemi ekzaminuar disa mostra përfshirë testet e substanciale dhe të pajtueshmërisë. Bazuar në to konkludojmë se AKK ka menaxhuar shpenzimet në këto kategori në pajtueshmëri më kërkesat ligjore.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime për këtë fushë.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuritë neto të AKK-së ishin 42,675€. Prej tyre 14,078€ ishin pasuritë me vlerë mbi 1,000€ të regjistruara në regjistrin kontabël, ndërsa 28,597€ ishin pasuritë jo-kapitale me vlerë nën 1,000€.

Ne kemi testuar nëse të gjitha pasuritë e përfituara gjatë vitit 2016 janë evidentuar në regjistrat përkatës si dhe nëse ato janë shpalosur në PFV. Gjithashtu kemi kryer një ekzaminim fizik të pasurisë për të verifikuar ekzistencën e tyre.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime për këtë fushë.

3.3 Obligimet e papaguara

Vlera e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 3,365€, të cilat rrjedhin nga faturat e pranuar në muajin dhjetor 2016.

Raportimi i obligimeve ishte bërë në përputhje me rregullën financiare nr.02/2013/MF, për raportimin e obligimeve të papaguara, andaj nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime për këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Drejtori i Agjencisë duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Drejtori i AKK-së duhet të sigurojë një plan të rishikuar të veprimit, i cili përcakton qartë një afat kohor dhe stafin përgjegjës për adresimin e të gjitha rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP). Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet në baza të rregullta kohore.		Përkundër progresit në zbatimin e rekomandimeve të AP-së, dy (2) prej tyre kanë mbetur të pa zbatuara.	
2.4 Lista kontrolluese e vet-vlerësimit të MFK-së	Drejtori i AKK-së duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vet-vlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për të konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.			Nuk janë marrë masa.
2.5.1. Vlerësimi i rrezikut	Drejtori i AKK-së duhet të sigurojë se kanë hartuar një plan për identifikimin, vlerësimin dhe evitimin e rreziqeve të cilat mund të paraqiten gjatë realizimit të objektivave strategjike dhe vjetore, si dhe ka caktuar një person përgjegjës për menaxhimin e rrezikut i cili raporton në baza mujore për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.			Nuk janë marrë masa.
3.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Drejtori i AKK-së duhet të përcaktojë arsyet e mos adresimit të rekomandimit dhe të sigurojë se me rastin e planifikimit të buxhetit, janë bërë analiza të hollësishme dhe janë identifikuar nevojat reale të shpenzimeve, përfshirë edhe kategorizimin e tyre. Më tutje, të siguroj se të gjitha shpenzimet janë regjistruar në kategoritë ekonomike adekuate.	Po		

3.4 Prokurimi	Drejtori i AKK-së duhet të sigurojë kontrolle shtesë në mënyrë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë ekzekutimin e tyre. Gjithashtu duhet të siguroj se janë forcuar kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPF-në, dhe me rregullat e Thesarit.	Po		
---------------	---	----	--	--

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



AGENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dept. Deps: <u>2-D</u> No. i flet. Kryq shkrimi No. pages: <u>01</u>	Nr. Prot. Nr. Prot.: <u>01-1483/17</u> Data Datum: <u>12-06-2017</u> PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të Agjencisë Kundër Korrupsionit, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Shaip Havolli

Drejtore i Agjencisë Kundër Korrupsionit,

Data: 12 Qershor, 2017 Prishtinë,

